

- Sek. Këshillit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT FIER  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1323/ prot.

Fier, më 12.01.2023

3 (v. 2022)

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 66, të Këshillit të Bashkisë Divjakë, të miratuar në mbledhjen e datës 23.12.2023.

**BASHKISË DIVJAKË**  
**KËSHILLIT TË BASHKISË DIVJAKË**

**Divjakë**

Me anë të shkresës Nr. 1323/1 datë 05.01.2023, ju kemi kërkuar që për vendimin Nr. 66, datë 23.12.2023, të dërgoni dokumentacionin plotësues të vendimit. Nga ana juaj me shkresën Nr. 6745/46 port. datë 09.01.2023, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1323/2 prot. datë 11.01.2023, është depozituar dokumentacioni plotësues i vendimit. Prefekti i Qarkut Fier, bazuar në ligjin Nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" neni 8, shkronja "a", neni 16, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, pasi verifikoi ligjshmërinë e vendimit me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Divjakë, shprehet si më poshtë:

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Divjakë Nr. 66, datë 23.12.2022, "Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Bashkinë Divjakë",** shoqëruar nga projektvendimi Nr. 78, datë 16.12.2022, i protokolluar me Nr. 6745/19 prot. datë 16.12.2022, relacioni Nr. 6745/20 prot. datë 16.12.2022, procesverbali i dëgjësës publike Nr. 4, datë 26.10.2022, Nr. 6, datë 27.10.2022, Nr. 12, datë 01.11.2022, Nr. 8, datë 02.11.2022, është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, shkronja "b", neni 41, pika 1; Ligjin Nr. 9936, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) neni 26, Ligjin Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 6, shkronja "ç", neni 36, neni 39; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore" si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2023-2025".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

